



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE

1. Emri i Institucionit:	Zyra Kombëtare e Auditimit
2. Titulli:	Udhëheqës i Njesisë për Projekte dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
3. Kodi Buxhetor:	13400
4. Kategoria Funktionale:	
5. Grada/Koeficienti:	
6. Lloji i vendit të punës:	Shërbyes Civil i Karrierës
7. Njësia Organizative:	Njësia për Projekte dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
8. Raporton tek:	Auditori i Përgjithshëm
9. Lokacioni:	Prishtinë

10. Qëllimi i Pozitës:

Udhëheqësi i Njesisë për Projekte dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, menaxhon dhe koordinon aktivitete bashkëpunuese ndërkombëtare të ZKA-së me ISA-të, dhe institucioneve të tjera, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe ngritjes së kapaciteteve të ZKA-së.

11. Detyrat Kryesore: (përshkrim i shkurtë i detyrave kryesore të radhitura sipas rëndësisë së tyre).

Detyra 1: Përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të ZKA-së, në shkëmbimin e informacionit dhe përvojave me Institucionet Supreme të Auditimit, për të maksimizuar dobitë dhe lehtësuar zhvillimin e qëndrueshëm të auditimit publik; 20%

Detyra 2: Përgjegjës për zhvillimin dhe planifikimin e propozime për bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve tjera si dhe vlerëson propozimet e pranuar nga jashtë; 15%

Detyra 3: Siguron përpunimin, koordinimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për pjesëmarrje në projekte të bashkëpunimit dhe siguron zbatimin e tyre; 15%

Detyra 4: Përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe bashkëpunuese; 15%

Detyra 5: Koordinon dhe ofron mbështetje për pjesëmarrjen e punonjësve të ZKA-së në grupe ndërkombëtare të punës dhe projekte të përbashkëta të auditimit; 10%

Detyra 6: Kryen funksionin ndërlidhës në aktivitetet me organizatat profesionale të auditimit dhe Institucionet Supreme të Auditimit; 10%

Detyra 7: Përgatit raporte periodike mbi aktivitetet e njësisë që kërkojnë shqyrtim nga mbikqyrësi 10%

Detyra 8: Kryen edhe detyra tjetër sipas kërkesave nga mbikqyrësi; 5 %

12. Përgjegjësia Mbikëqyrëse (Po/Jo)

JO

13. Përgjegjësia Financiare: (Po/Jo)

JO

14. Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti, në fushën e ekonomisë, drejtësisë apo administratës publike;
- Përvojë pune profesionale së paku prej gjashtë (6) vitesh, prej tyre tri (3) vite përvojë menaxheriale;
- Të posedoj aftësi të mira komunikimi dhe në të shkruar për gjuhët zyrtare dhe gjuhës angleze.

15. Shkathësitë e kërkuara:

- Aftësi hulumtuese në projekte relevante për veprimtarinë e ZKA-së;
- Aftësi në hartimin, prezantimin dhe koordinimin e projekteve;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale;
- Shkathësi të mira organizative;
- Shkathësi të mira në komunikim.

16. Nënshkrimet dhe Aprovimet

Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë

<i>Emri:</i>	<i>Nënshkrimi</i>	<i>Data</i>
--------------	-------------------	-------------

Përgjegjësi për Burime Njerëzore

<i>Emri:</i>	<i>Nënshkrimi</i>	<i>Data</i>
--------------	-------------------	-------------

Auditori i Përgjithshëm

<i>Emri:</i>	<i>Nënshkrimi</i>	<i>Data</i>
--------------	-------------------	-------------